

NJOFTIM PER POZICION TE LIRE PUNE

Junior Marketing Specialist

❖ PERSHKRIM I SHKURTER I KOMPANISE

Gener2 përfaqëson një nga kompanitë më me emër në sektorin e ndërtimeve e të zhvillimit të infrastrukturës në Shqipëri. Kompania zotëron një gamë të zgjeruar aktiviteteve të shtrira në industri të tilla si ndërtim, infrastrukturë e menaxhim projektsh inxhinierike, energji e telekomunikacion, menaxhim pronash e pasurish të paluajtshme, aktivitete komerciale, ISP dhe media. Në rrugëtimin afro 30 vjeçar, kompania Gener 2 ka prezantuar risi që kanë lënë gjurmë në tregun shqiptar e atë rajonal, duke zhvilluar projekte strategjike, duke zbatuar standarde të larta cilësore të bazuara në eksperiencat më të mira bashkëkohore ndërkombëtare, duke kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit.

❖ PERSHKRIM I POZICIONI TE LIRE TE PUNES

Pozicioni përfshin detyra specifike në fushën e marketingut digjital me shërbim të informimit publik mbi aktivitetet e kompanisë, promovimit të projekteve në zhvillim, apo atyre të realizuara, si dhe paqyrimin të komponentë të biznesit apo produkteve sipas nevojave specifike.

Pozicioni kërkon menaxhim të profileve në rrjetet sociale për bizneset që janë pjesë e kompanisë, nisur prej planifikimit, zhvillimit dhe deri tek arritjet e objektivave e rezultateve të pritshme në përputhje këto planifikime, si dhe të punëve të realizuara në koordinim me pjesëtarët e tjerë të skuadrës.

Pozicioni kërkon shfrytëzimin e të gjithë rrugëve të komunikimit të brendshëm e të jashtëm me qëllim informimin, promovimin, si dhe komunikimin me kolegë, partnerë biznesi apo më gjerë. Vecanërisht, në këtë rol kërkohet aplikimi i standardeve në përdorimin e brandit/firmës në cdo aspekt të aktiviteteve të marketingut.

Pozicioni kërkon një pjesëtar aktiv, pasionant dhe novator në skuadër që ka në përgjegjësi planifikimin, menaxhimin si dhe realizimin e detyrave sipas interesave dhe strategjisë së kompanisë. Kandidati pritet të ketë aftësitë e vullnetin në zbatimin e të gjitha rregullave, politikave dhe proceseve operacionale që kompania aplikon.

❖ DETYRAT | PERGJEGJESITE

Marketing Digjital

- Në bashkëpunim me dizajnerin grafik, krijon formatet/template të nevojshme sipas kërkesës;
- Planifikon nevojat për përmbajtje imazhi për profilet e rrjeteve sociale të kompanisë, e bashkëpunon ngushtë me producentin e foto-videove dhe dizajnerin grafik me qëllim që planet ditore, javore dhe semestrare të realizohen suksesshëm;
- Kryen postimet në profilet e rrjeteve sociale, raporton dhe mbikqyr ato sipas planit, duke realizuar edhe përmbajtjen e tekstit (copywriting);
- Mbikqyr vijueshmërinë e komenteve e të reagimeve të ndjekësve. Vendos barriera për raste të thyerjes së etikës në komunikim, si dhe ndjek gjithashtu komunikimet e marra përmes rrjeteve sociale, duke zbatuar etikën profesionale në komunikim.
- Bazuar në formatin e miratuar, përpilon raportin mujor për analizën e secilit profil në rrjetet sociale përmes të dhënave që gjenerohen prej ‘google analytics’ si dhe të treguesve të tjerë të monitoruar përgjatë muajit.

- Realizon në bashkëpunim me dizajnerin grafik materialet digjitale sipas nevojës së kompanisë për mediaplanet, si dhe ndjek shërbimet në lidhje me mediabuy respektive;
- Në rastet e eventeve të bizneseve, të aktiviteteve bamirëse apo të ngjashme, punon afër me dizajnerin grafik si dhe producentin e foto-videove për realizimin e promovimit të tyre digjital;
- Siguron që në cdo rast publikimi apo përdorimi të logos/ve zbatimin e kushteve të bradit/brandimit;
- Punon në skuadër për kontentin e kërkuar për pasurimin e informacioneve dhe përmbajtjes në faqen/t e internetit;

Të tjera

- Identifikon tendencat e nevojat duke zbatuar teknologjinë më të fundit me ndikim e industrinë përkatëse;
- Mban marrëdhënie të mira bashkëpunuese e ndërvepruese me kolegët në skuadër, si dhe me ata të departamenteve të tjera në kompani, gjatë realizimit të planeve e punëve të përbashkëta;
- Si pjesë e skuadrës, kontribon në vendosjen e marrëdhënieve të mira partneriteti edhe me palë të treta, përfshirë media, agjenci, universitete, biznese apo bashkëpunëtorë të tjerë.
- Kontribon në prodhimin dhe shpërndarjen e të gjitha materialeve offline të të gjitha publikimeve të kompanisë;
- Kontribon në mbarëvajtjen e fushatave të komunikimit, përmbajtjen respektive dhe zhvillimin e materialeve promovuese të kompanisë;

❖ KRITERET

- Diplomë Master (e preferueshme Marketing dhe/ose Komunikim);
- Mbi 3 vite eksperiencë në detyra në fushën e marketing-ut;
- Njohuri të përdorimit të kanaleve të komunikimit (Meta business, LinkedIn, Youtube, web content);
- Njohuri për plotësimin e detyrave të marketingut digjital;
- Aftësi të mira tekstshkruese;
- Aftësi në menaxhimin e mirë të kohës, duke evidentuar prioritetet;
- Aftësi në dizajn grafik përbëjnë një avantazh.

❖ AFTESI TË TJERA

- Njohuri të programeve të dizajnit (Adobe dhe Canva);
- Aftësi për të punuar në grupe të ndryshme pune;
- Aftësi angazhimi e përfshirje bashkëpunimi me kolegët;
- Njohuri në mirë-menaxhimin e kostove, sipas planit;
- Përqasje në ngritjen e problemeve duke sjellë zgjidhje për to;
- Aftësi në menaxhim të situatave nën presion, duke respektuar afatet e vendosura.

Kandidatët e interesuar janë të lutur të dërgojnë CV nëpërmjet adresës elektronike: careers@gener2.al ose të plotësojnë formularin e aplikimit në faqen zyrtare www.gener2.al në seksionin “**apliko online**”.

Afati i fundit i aplikimit është **data 19 Janar 2023, ora 17:00**.

* Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të kontaktohen.

* Të gjithë aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet sipas ligjit Nr. 9887 të vendosur nga Parlamenti i Shqipërisë mbi “Mbrojtjen e të dhënave personale”.